



Pranuar / Prerregulluar Punëdhënësi/Prerregulluar Received/Delivered	27. 01	2021	viti god year
Organ / Niveli Organ / Jedinita Org / Unit	Nr Prof Br Prof Prof No	Shtojta Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMHA	334/2021		1/3



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.380/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.380/2020 të datës 01.12.2020 të parashtruar nga ankuesi të cilin me autorizim e përfaqëson Avokat më adresë rruga “Sheshi Edit Durham”, nr.3, kati I, hyrja nr.2 në Prishtinë, kundër Vendimit me Nr.207/2020 të datës 18.11.2020 të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike “*transferim i përkohshëm*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 27.01.2021, mori këtë:

### V E N D I M

I. REFUZOHET si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.380/2020 e datës 01.12.2020, e parashtruar nga ankuesi

II. MBETET në fuqi Vendimi me numër Nr.207/2020 i datës 18.11.2020 për transferim të përkohshëm të ankuesit në pozitën “Udhëheqës i Drejtoratit për Trajnime dhe Zhvillim” në Akademinë Diplomatike, në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

### A r s y e t i m

Ankuesi Udhëheqës i Departamentit për Çështje Konsullore pran Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me datë 18.11.2020 përmes Vendimit Nr.207/2020 të Sekretarit të Përgjithshëm, është transferuar përkohësisht në pozitën e punës Udhëheqës i Drejtoratit për Trajnime dhe Zhvillim në kuadër të Akademisë Diplomatike pran Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Kundër Vendimit Nr.207/2020 të datës 18.11.2020 të Sekretarit të Përgjithshëm, ankuesi më datë 01.12.2020 ka parashtruar ankesë me numër Anr.380/2020, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurale dhe materiale, dhe vërtetimit jo të plote dhe të drejte të gjendjes faktike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 24.12.2020, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës. Këshilli, më datë 14.01.2021 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 13.01.2021 ka nxjerrë vendimin me numër VK.nr.01/2021, me të cilin i është vazhduar afati i ankesës së ankuesit \_\_\_\_\_ për të vendosur edhe për 10(dhjetë) ditë të tjera.

**Kolegji për Shqyrtimin Ankesave për marrjen e vendimit meritor ka administruar këto prova:** ankesë e datës 01.12.2020 me numër Anr.380/2020, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 29.10.2020 me numër Anr.268/2020 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimit me Nr.207/2020 të datës 18.11.2020 dhe Vendimi me numër Nr. 201/2020 i datës 12.11.2020 i sistemuar në mënyrë të përkohshme në pozitën “Udhëheqës i Drejtoratit për Trajnime dhe Zhvillim” në Akademinë Diplomatike; Vendimin me numër VK.nr.01/2021 i datës 13.01.2021 për vazhdim të afatit; Përgjigje në ankesë e datës 14.01.2021; Akte emërimi Nr.188 i datës 19.12.2016; Vendimin me Numër 129/2019 i datës 01.11.2019; Vendimin me Nr. 95/2020 i datës 17.08.2020; Vendimin me Nr. 157/2016 i datës 09.12.2016; Ankesën me Nr. Prot:1761/2020 të datës 15.09.2020 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin për përfaqësim; Dekretin e datës 17.07.2013 të Presidentes së Republikës së Kosovës; Vendim me Numër 35/2017 i datës 07/02/2017; Vendimin me Numër 459/2019 i datës 31/10/2019; E-maili i datës 21.07.2020 nga Afërdita G. Krasniqi për \_\_\_\_\_ Vendimin e datës 20.07.2011 të Ministrit të Punëve të Jashtme; Vendimin me Nr. 338/2016 i datës 12.08.2016; Vendimin me Nr.Ref. 305/2019 i datës 01.07.2019; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Drejtor i Drejtoratit për Trajnime dhe Zhvillim në Akademinë Diplomatike i datës 17.04.2015; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Drejtor i Departamentit për Çështje Konsullore dhe Përgjigjen në ankesë e datës 28/09/2020; Email zyrat i datës 21.01.2021 dhe i datës 22.01.2021.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka vërtetuar se ankesa e ankuesit \_\_\_\_\_ *është e pa bazuar, sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji ka konstatuar se ankuesi sipas Vendimit Nr.129/2019 të 01.11.2019 mban pozitën e punës Udhëheqës i Departamentit për Çështje Konsullore pran Ministrisë se Punëve të Jashtme. Me datë 17.08.2020 ankuesi përmes Vendimit Nr.95/2020 të Sekretarit të Përgjithshëm, është transferuar përkohësisht në pozitën e punës Udhëheqës i Drejtoratit për Trajnime dhe Zhvillim në kuadër të Akademisë Diplomatike pran Ministrisë se Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Kundër Vendimit Nr.95/2020 për transferim të përkohshëm, ankuesi me datë 15.09.2020 ka parashtruar ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përmes Vendimit A.nr.268/2020 ankesën e ankuesit e ka kthyer në rishqyrtim, për shkak se vendimi për transferim nuk ka specifikuar kohën dhe arsyen e transferimit të nëpunësit civil.

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë se Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me datë 18.11.2020 në proces të rishqyrtimit, ka nxjerr Vendimin tjetër me Nr.207/2020 përmes të cilit ankuesin e ka transferuar nga pozita e punës Udhëheqës i Departamentit për Çështje Konsullore, në pozitën e punës Udhëheqës i Drejtoratit për Trajnime dhe Zhvillim në kuadër të Akademisë Diplomatike pran Ministrisë se Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, bazuar në shkresat e lëndës, përkatësisht Vendimin me Nr.207/2020 të datës 18.11.2020, ka gjetur se transferimi i ankuesit është bërë për interes të institucionit për shkak se pozita e Udhëheqësit të Drejtoratit për Trajnime dhe Zhvillim ka mbet e lire, andaj me qëllim të menaxhimit të punëve dhe detyrave, për një periudhë në afat prej gjatë (6) muajve, ka ardhur deri te transferimi i nëpunësit civil.

Bazuar në e-mailin e datës 22.01.2021 të Divizioni për Burime Njerëzore pran Ministrisë se Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Kolegji ka konstatuar se ankuesi \_\_\_\_\_ në pozitën e transferuar përkohësisht si Udhëheqës i Drejtoratit për Trajnime dhe Zhvillim, e ka koeficientin e pagës dhjetë (10) njëjtë me koeficientin e pagës se mëparshme si Udhëheqës i Departamentit për Çështje Konsullore.



Andaj, duke i'u referuar dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht të nenit 52 ku përcaktohet se: "1. Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil të së njëjtës kategori, në këto raste: 1.1. kur është në interes të institucionit, deri në 6 muaj gjatë 2 vjetëve; 1.2. për përmirësimin e rezultateve të vetë nëpunësit, deri në 3 muaj gjatë 2 vjetëve; 1.3. për arsye të përkohshme shëndetësore në bazë të vendimit të komisionit kompetent, sipas ligjit, për aq sa është e nevojshme, sipas vendimit të komisionit përkatës", si dhe duke u bazuar në shkresat e lëndës, ku shihet se ankuesi është transferuar nga pozita e Udhëheqësit të Departamentit për Çështje Konsullore, me koeficient të pagës 10, në pozitën e punës Udhëheqës i Drejtoratit për Trajnime dhe Zhvillim, po ashtu me koeficient të pagës 10, për një periudhe të caktuar kohore prej 6 muajsh, Kolegji vlerëson se pretendimi ankimor i ankuesit është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit se pozita e punës Udhëheqës i Drejtoratit për Trajnime dhe Zhvillim, në të cilën është transferuar ankuesi është pozite e nivelit të divizionit, dhe nuk konsiderohet pozite e kategorisë së njëjtë me pozitën e mëparshme, Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.01/2012 për Funkcionimin e Akademisë Diplomatike, përkatësisht nenin 8 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3.1 ka konstatuar se pozita në të cilën është transferuar ankuesi emërtohet Drejtorati për Trajnime dhe Zhvillim, kështu që pretendimi ankimor i ankuesit në këtë kuptim është i pa bazuar.

Kolegji për Shqyrtimin Ankesave, vlerëson se Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr.207/2020 të datës 18.11.2020 për transferimin e përkohshëm të ankuesit në pozitën e punës "Udhëheqës i Drejtoratit për Trajnime dhe Zhvillim" në Akademinë Diplomatike" në afat prej 6 muajsh, për interes të institucionit, ka vepruar në me nenin 52 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, si dhe nenin 4 paragrafin 1 të Rregullores (QRK)Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**  
**Lënda me numër A.nr.380/2020**



**Zyle Millaku GOJNOVCI**  
Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

**Vendimi i dërgohet**

- Përfaqësuesit të ankuesit Avokatit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës: dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

